



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHERBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina ish-hotel "Drini", Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 528 prot.

Tiranë, më 16.05.2017

V E N D I M

Nr. 120, datë 16.05.2017

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ
filluar me urdhrin nr. 744/1, datë 11.01.2017**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neneve 79-90, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 744 prot., datë 14.12.2016, për disa pretendime të ngritura që kanë të bëjnë me procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të punonjësit *****,

VËREJ SE:

Pas njohjes me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunësit ***** me urdhrin nr. 744/1 prot., datë 11.01.2017, të Komisionerit, ka nisur verifikimi paraprak i çështjes, në përfundim të të cilit, rezultoi sa më poshtë:

Nëpunësi ***** ka qenë i emëruar në pozicionin "*Inspektor i Parë*", në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj dhe me aktin nr. 1603/398, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, është deklaruar nëpunës civil.

Rezulton se, me urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "*Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore*" është miratuar struktura e re organizative dhe funksionale e administratës tatimore qendrore.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 158, datë 20.09.2016, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”*, ka vendosur ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili më tej me urdhrin nr. 158/1, datë 10.10.2016, të DAP, ka ndryshuar përbërjen e tij.

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, Komisioni i Ristrukturimit ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë prekur nga ristrukturimi. Rezulton se, për punonjësin ***** , Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e tij nga pozicioni *“Inspektor i Parë”*, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj, me kategori page III-b, në pozicionin e punës *“Specialist në Qendrën e Thirrjeve”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, katgoria e pagës IV-a.

Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të pikës 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, me aktin nr. 6887/130, datë 10.11.2016, *“Transferim për shkak të ristrukturimit”*, ka vendosur transferimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës *“Specialist në Qendrën e Thirrjeve”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me kategori page IV-a. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se ky punonjës ka marrë dëgjimin për këtë akt në datën 15.11.2016.

Duke mos qenë dakord me vendimin e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, nëpunësi ***** , brenda afatit 5 ditor nga data e marrjes dëgjimit, i është drejtuar njësisë përgjegjëse (DAP) me shkresën nr. 7099, datë 17.11.2017, *“Mbi vendimin e transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, nëpërmjet të cilës nuk e ka refuzuar transferimin e tij në pozicionin aktual në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nga ana tjetër ka kërkuar rishikimin e vendimit dhe revokimin e propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, për shkak se transferimi i përhershëm nuk është bërë në një pozicion të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Njëkohësisht, rezulton se ky punonjës me shkresën nr. 37615 prot, datë 17.11.2016, ka kërkuar rishikimin e pozicionit të punës në fjalë edhe nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në zbatim të vendimit të Departamentit të Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me aktin administrativ nr. 980, datë 21.11.2016, *“Për transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, ka vendosur transferimin e këtij punonjësi në pozicionin e miratuar nga njësia përgjegjëse.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke trajtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e veprimit administrativ të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit, për punonjësin ***** , konstaton se procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

Kjo dispozitë ligjore përcakton se: “Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori”. Për sa përcaktohet në këtë dispozitë, ligjshmëria e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësit civil, në kuadër të ristrukturimit, kërkon plotësimin e dy kushteve themelore, konkretisht:

- a) pozicioni i mëparshëm të mos ekzistojë më, çka nënkupton të jetë suprimuar, shkurtuar ose riorganizuar dhe,
- b) nëpunësi civil, pozicioni i të cili preket nga ristrukturimi, duhet të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Nga përmbajtja e materialit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se Sektori i Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, të Drejtorisë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj, në të cilën ushtronte detyrën nëpunësi *****, është përfshirë në një proces ristrukturimi. Sipas strukturës së mëparshme, ky sektor ishte i organizuar me 6 pozicione pune, me emërtesën “Përgjegjës Sektori” dhe 78 pozicione pune me emërtesën “Inspektor”. Aktualisht, sipas strukturës së re, ky sektor është i organizuar me 4 pozicione pune me emërtesën “Përgjegjës Sektori” dhe 65 pozicione pune me emërtesën “Inspektor”.

Nga krahasimi i dy strukturave, konstatohet përmbushja e kushtit të parë, pasi ristrukturimi ka prekur pozicionin në të cilin ka qenë i emëruar ankuesi, konkretisht Sektori i Kontrollit Tatimor është shkurtuar me **13 pozicione** pune me emërtesën “Inspektor”.

Në kuptim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicioni i punës “Inspektor”, klasifikohet si pozicion i nivelit ekzekutiv. Ky fakt provohet dhe me shkresën nr. 7720/1, datë 27.12.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Kthim përgjigje”, në të cilën arsyetohet se: “...pozicionet e shërbimit civil klasifikohen në katër kategori, një ndër të cilat është **kategoria ekzekutive**, në të cilën në kuptim të strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, **përfshihen ato pozicione që i përkasin kategorive III-b, IV-a, IV-b dhe IV-c**”. Në këto raste, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, e ka unifikuar pozicionin e punës në kategorinë ekzekutive.

Më tej, ligjshmëria e procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit analizohet dhe në përputhje me strukturën aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga këqyrja e strukturës organizative të këtij institucioni, konstatohet se pozicionet e punës me emërtesën “Inspektor”, me kategori page III-b dhe pozicionet e punës “Specialist”, me kategori page IV-a, IV-b dhe IV-c, ndodhen në të njëjtën shkallë hierarkie dhe raportojnë për kryerjen dhe realizimin e detyrave të “Përgjegjësi i Sektorit”.

Për më tepër, në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se emërimi i nëpunësve civilë në pozicionet e nivelit ekzekutiv, ku në rastin konkret klasifikohet dhe pozicioni “Inspektor”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, bëhet fillimisht nëpërmjet lëvizjes paralele, në të cilën kanë të drejtën e konkurrimit të gjithë ata nëpunës, të cilët i përkasin të njëjtës kategori (konkretisht nëpunësit civilë, të cilët ushtrojnë detyrën në pozicionin e punës “Specialist” me kategori page IV-a, IV-b dhe IV-c, si dhe në

pozicionin e punës “Inspektor”, kategoria e pagës III-b) dhe nëse nuk ka kandidatë të kualifikuar për këtë fazë, procedura e rekrutimit vazhdon me procedurën e pranimit nga jashtë.

Dispozitat e mësipërme ligjore, përcaktojnë se transferimi i përhershëm në kuadër të ristrukturimit, i nëpunësit *****, në pozicionin “Specialist në Qendrën e Thirrjeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me kategori page IV-a, është kryer brenda të njëjtës kategori, sipas përcaktimeve të nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në analizë të dokumenteve shkresore të administruara dhe legjislacionit në fuqi, përfundimisht çmoj se, pretendimi i parashtruar nga nëpunësi *****, nëpërmjet kërkesës nr. 744, datë 14.12.2016, për paligjshmëri në zhvillimin e procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me urdhrin nr. 744/1, datë 11.01.2017, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësi *****, në lidhje me disa parregullsi të pretenduara gjatë procesit të ristrukturimit dhe transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ankuesi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA